



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201802500/9**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda:**            *Rekomandim për respektimin e të drejtave të fëmijëve në kopshtin  
22 Tiranë.*

**BASHKISË TIRANË**

**QENDRËS EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË  
FËMIJËVE**

**ZONJËS ZHANETA BEQIRI**

**DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE**

**TIRANË**

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të attributeve që i jepen nga Kushtetuta dhe ligji nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, kërkoi informacion nga autoritetet përgjegjëse shtetërore dhe kopje të dokumentacioneve përkatëse, mbi problematikat e ngritura në ankesën drejtuar këtij institucioni nga shtetësja Ina Kasimati.

Në shkresën zyrtare 85/1 prot., datë 30.1.2019, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, na ka vënë në dispozicion informacionin përkatës, shoqëruar me kopje të dokumentacioneve, për numrin e fëmijëve që kanë frekuentuar kopshtin nr.22 Tiranë, të ndarë sipas grup-moshave dhe kopjen e pagesave mujore të tyre, për periudhën shtator-dhjetor 2018.

Nga verifikimi i dokumentacioneve konstatojmë, se frekuentimi i kopshtit nr.22, për periudhën shtator –dhjetor 2018, nuk është në përputhje me shkronjën "A", të pikës 1, të udhëzimit nr.30, datë 12.9.2018, të ministrit të

Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

Konkretisht, grupi i tretë B, i kopshtit nr.22 Tiranë, përveç datës 17.9.2018, është frekuentuar me më pak se 25 fëmijë. Në këtë grup, zhvillon mësim edhe drejtori i këtij institucioni, znj.Aurora Toska.

Në shkresën me nr. 114/1 prot., datë 17.1.2019, Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit të Tiranës, na ka vënë në dispozicion kopje të dokumentacioneve si vijon:

- rregulloren e kopshtit;
- shkresën zyrtare, ku për nevojat e institucionit arsimor publik është njoftuar znj. Aurora Toska, drejtues i komanduar në kopshtin nr.22, Tiranë, për ushtrimin e këtij funksioni;
- kopje të procesverbalit, ku prindërit kanë patur dakordësinë e kalimit të znj. Mimoza Imeraj në grupin e dytë;
- kopje të procesverbalit, ku ndarja e edukatoreve sipas grupeve për ciklin mësimor 2018-2019 në kopshtin nr.22, ka patur dakordësinë e edukatoreve.

Në rregulloren e kopshtit nr.22 Tiranë, të vënë në dispozicion nga Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit të Tiranës, është konstatuar, se në përmbajtje të saj nuk është parashikuar asgjë për të drejtat dhe detyrimet e prindërve.

Në mbështetje të pikave 8 dhe 9, të nenit 6, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sistemi arsimor parauniversitar garanton të drejtat e prindërve për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t’u dëgjuar për këto pikëpamje, si dhe për t’u organizuar për të dhënë ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit. Në këtë kuptim, rregullorja e kopshtit nuk është në përputhje me parimet e përgjithshme, që burojnë nga ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në shkresën me nr.764 prot., datë 1.3.2018, ku është marrë vendimi nr.14, datë 1.3.2018, për emërimin e komanduar të drejtorit të kopshtit nr.22 Tiranë, është konstatuar, se ky emërim nuk është në përputhje me nenin 55, të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi ligji nuk e njeh konceptin e “komandimit”.

Në këtë kuptim, në shkronjën “C”, të udhëzimit nr.57, datë 12.11.2013, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucioneve publike të arsimit parauniversitar”,

është parashikuar zvendësimi i përkohshëm i drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, i cili zvendësohet nga nëndrejtori dhe, kur institucioni i arsimit parauniversitar nuk ka nëndrejtor, nga një mësues i institucionit.

Për sa më sipër, zbatimi jo korrekt i akteve nënligjore të sipërpërmendura, kanë passjellë marrjen e vendimeve nga drejtuesi i kopshtit nr.22, të cilat nuk janë brenda kompetencave ligjore të ushtrimit të detyrës së ngarkuar. Konkretisht, konstatojmë shkelje të legjislacionit në fuqi, për sa i përket shpërndarjes së edukatoreve dhe sanitareve, sipas grupeve të fëmijëve të kopshtit nr.22 Tiranë, (vendimit nr. 189 prot., datë 10.9.2019).

Në shkresën zyrtare nr.1672/1 prot., datë 13.3.2019, Komisariati i Policisë nr.4, Tiranë, informoi institucionin e Avokatit të Popullit, se në datën 17.9.2018, inspektori Erjon Nako është njoftuar nga drejtoresha e kopshtit Aurora Tosku në datën 17.9.2018, për një problem që kishte në zyrën e saj. Ai ka shkuar në zyrën e drejtorit të kopshtit nr.22 Tiranë, ku është njohur me problematikën dhe i ka kërkuar znj.Toska, që brenda mundësive të marrë në konsideratë kërkesën e prindërve, për të riparë edhe një herë vendimin e marrë nga ana e saj, për ndryshimin e edukatores në grupin e fëmijëve të prindërve të pranishëm në zyrë. Drejtuesi i këtij kopshti nuk shprehu dakordësi për ndryshimin e vendimit dhe ai i ka orientuar prindërit për t'ju drejtuar Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve në Bashkinë Tiranë.

Për sa më sipër, referuar problematikave të evidentuara nga analizimi i kopjeve të dokumentacioneve të vëna në dispozicion nga autoritete shtetërore konstatojmë, se mosfunksionimi i të gjitha hallkave zinxhir të këtij sistemi dhe zbatimi jo korrekt i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kanë sjellë mungesën e përgjegjësisë në ushtrimin e detyrës, si drejtues i komanduar nga znj.Aurora Toska me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme për edukimin e fëmijëve.

Thënë kjo, në mbështetje të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, gjukojmë, se krijimi i kushteve të përshtatshme për edukimin e fëmijëve në institucionet arsimore parauniversitare, është përgjegjësi e një trekëndëshi institucional, të përbërë nga prindërit, institucioni arsimor, nëpërmjet mësuesve dhe vetë fëmijëve.

Në mënyrë që edukimi i fëmijëve të kryhet në një mjedis të qetë, duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, kërkohet nga institucionet shtetërore përgjegjëse ndërmarrja e hapave ligjorë e procedural,

që raste të tilla të parandalohen në kohë dhe të minimizohen sa më shumë të jetë e mundur.

Me qëllimin dhe dëshirën e mirë, që situata të tilla të mos përsëriten dhe, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijës, i cili nënkupton të drejtën e fëmijës për të patur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe në respektim të legjislacionit në fuqi, institucioni i Avokati të Popullit, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave për emërimin përfundimtar të drejtuesit të kopshtit nr. 22 Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi.
- Marrjen e masave për transferimin e znj.Aurora Toska në një kopësht tjetër, në përfundim të këtij viti shkollor.
- Marrjen e masave, për hartimin e rregullores së funksionimit dhe organizimit të kopshtit nr.22 Tiranë, në përputhje me legjislacionit në fuqi.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

**K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**